

VENDIM
Nr. 440, datë 22.5.2013

PËR PRODUKTET QË PËRMBAJNË DIMETILFUMARAT¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 480, datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndalimin e vendosjes dhe bërjes së disponueshme në treg të produkteve që përmbajnë dimetilfumarat (DMF).

2. Për qëllime të këtij vendimi:

a) “Dimetilfumarat (DMF)” është përbërja kimike dimetilfumarat, me emërtimin dimetil (E) – butendioat, sipas IUPAC, numër CAS 624-49-7 dhe nr. Eiencs 210-849-0. DMF-ja është një biocid që përdoret nga prodhuesit për të parandaluar shfaqjen e mykur (kërpudhave) që mund të formohen te produktet e konsumatorit gjatë magazinimit dhe transportit në kushte klimaterike të lagështa.

b) “Produkt që përmban DMF” është çdo produkt ose çdo pjesë e produktit, ku:

i) vihet re prania e DMF-së në një ose më shumë porcione/qese; ose

ii) përqendrimi i DMF-së është më i madh se 0.1 mg/kg e peshës së produktit ose pjesës së produktit.

3. Ngarkohet struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, e parashikuar në legjislacionin për sigurinë e përgjithshme të produkteve, për:

a) ndalimin e vendosjes dhe bërjes së disponueshme në treg të produkteve që përmbajnë DMF.

b) marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të siguruar tërheqjen nga tregu dhe kthimin mbrapsht nga konsumatorët të produkteve që përmbajnë DMF;

c) njoftimin e ministrisë përgjegjëse në fushën e tregtisë, në rast të marrjes së masave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike të vendimit.

4. Ngarkohen autoritetet doganore për të siguruar ndalimin e importit të produkteve që përmbajnë DMF-të dhe njoftimin e strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e zbatimit nga 1 janari 2014.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

¹ Ky vendim ka përafuar plotësisht vendimin e Komisionit nr.2009/251/EC, datë 17 mars 2009, ku u kërkohet shteteve anëtare të garantojnë që produktet që përmbajnë dimetilfumarat të mos vendosen apo të bëhen të disponueshme në treg, CELEX nr. 32009D0251, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, seria L, nr. 74, datë 20.3.2009, f. 32-34.